

BUSINESS **NEWS**

janar - dhjetor 2021



Indeksi

MJESHTËRO BIZNESIN

Nga Vasil Naçi
4

DHURO BUZËQESHJE ME LAY'S

LAY'S DHUROI BURSA
PËR 20 STUDENTË
TË EKSELENCËS
6-7

ELBAR

FESTA E MIQËSISË
12

RRUGA DREJT SUKSESIT

Nga Vasil Naçi
5

SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË

Prioritet në
Agnà Group
8-9

PRODUKTE TË REJA

16-17



BUSINESS NEWS

AKTIVITETE

Sociale, kulturore,
sportive
24-25

METAVVERSE

Jeta virtuale =
jeta fizike
30-31



MASTER YOUR BUSINESS

By Vasil Naçi
34

THE ROAD TO SUCCESS

By Vasil Naçi
35





“Nga përvoja e jetës sime kam mësuar se nëse dikush ka dëshirë të madhe për të arritur diçka, arsye të forta, besim te vetja, disiplinë dhe përkushtohet me gjithë qenien e tij, do ta arrijë atë, herët ose vonë. E gjitha nis brenda tij.” – Vasil Naçi

RRUGA drejt SUKSESIT

nga VASIL NAÇI

MJESHTËRO BIZNESIN

nga VASIL NAÇI

Përtej sfidave të kohës që po jetojmë ky vit solli një dhuratë të shkëlqyer për komunitetin e biznesit, event-trajnimin “Mjeshtëro Biznesin”, një program tërësisht kushtuar biznesit, i organizuar për herë të parë në Shqipëri. Një mundësi fantastike për cilindo që dëshiron të rritet dhe ta çojë një hap më tej sipërmarrjen e tij.

I krijuar prej kërkesave të sipërmarrësve dhe individëve të dashuruar me biznesin, për të përfituar nga njohuritë, modelet dhe praktikatat më të suksesshme në nivel lokal dhe global, “Mjeshtëro Biznesin” u ndërtua me synimin të ofrojë njohuri, mjete, praktika dhe strategji për rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në rrethanat e kufizimeve nga pandemia, ky edicion i parë i “Mjeshtëro Biznesin” u zhvillua online, në lidhje të drejtpërdrejtë përmes platformës ZOOM. Përgjatë katër

ditëve, 20-23 maj, Vasil Naçi dhe një skuadër ekspertësh të ftuar: Prof. Sherif Bundo, Dr. Julia Goga-Cooke, Dr. Alma Bici, Dritan Mezini dhe Arti Marko, ndanë me të mirën e dijes dhe përvojës së tyre, si dhe të praktikave më bashkëkohore në financë, marketing, transformim dixhital, inovacion, shitje, etj.,

Edhe pse në distancë, “Mjeshtëro Biznesin” u mundësoi pjesëmarrësve shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave, kohë të vlefshme reflektimi mbi bizneset e tyre, vizionin dhe prioritetet në menaxhimin e tij, si dhe përjetimin e përfitimit të njohurive kombinuar me një nivel të lartë energjie.

Hapja gjithnjë e më e madhe e mjedisit ekonomik shqiptar, përballja me mbingarkesën e informacionit dhe ndryshimet e shpejta, kërkojnë prej bizneseve qartësi dhe vendimmarrje efikase. Investitorët apo sipërmarrësit që synojnë sukses janë të vetëdijshëm që rruga e rritjes dhe zhvillimit është ajo më e sigurt. E pikërisht për të përshpejtuar ritmin e suksesit duke kursyer kohë dhe energji, ata përkujdesen të gjejnë dhe ndjekin modelet apo praktikatat më të mira.

“Mjeshtëro Biznesin”, tashmë pjesë e event-trajnimeve që Vasil Naçi zhvillon si pjesë e përgjegjësisë sociale dhe dëshirës për të kontribuar në komunitet, erdhi në një moment kritik pandemie, për të përcjellë mesazhin se kohërat e sfidave të mëdha, janë edhe kohërat e oportuniteteve të mëdha, janë kohëra për ndryshime, përmirësime dhe rritje eksponenciale. Çdo sfidë e kaluar me sukses nënkupton më shumë pjesë tregu, më shumë fitime, më shumë rritje.

Tradita vazhdon më e fuqishme dhe më e bukur. Nisur në 2016-tën, event-trajnimi “Rruga Drejt Suksesit” zhvilloi këtë vit edicionin e tij të gjashtë. Një organizim perfekt nga “Aga Leadership Academy” dhe “On Time Concept”. Gjashtë vite rritje, suksese dhe mijëra pjesëmarrës entuziastë dhe të përkushtuar ndaj zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Për të dytin vit radhazi, në një fundjavë të gjatë që nisi në mesditën e datës 19 nëntor e që përfundoi tre ditë më pas, “Rruga Drejt Suksesit” u zhvillua në lidhje të drejtpërdrejtë (online) për më shumë se 25 orë, në platformën ZOOM. Rreth 2,000 pjesëmarrës që besojnë tek rritja dhe zhvillimi personal si rruga më e mirë që garanton sukses, e ndoqën eventin drejtpërdrejt dhe qindra të tjerë në grupe me stafin, miqtë apo me familjet e tyre.

Formati virtual bëri të mundur që edhe këtë vit “Rruga Drejt Suksesit” të ndiqej në mbi 15 vende të ndryshme si: (SHBA, Itali, Zvicër, Mbretëria e Bashkuar, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Serbi, Greqi, Gjermani, etj).

Organizatori dhe folësi kryesor Vasil Naçi, sipërmarrës, themelues, President dhe CEO i Aga Group, me një përvojë mbi 30 vjeçare në biznes, autor librash për biznesin dhe zhvillimin personal, trajnuar nga më të mirët në fushën e biznesit, ndau me pjesëmarrësit njohuritë më të mira bashkëkohore për rritjen dhe zhvillimin personal e profesional. Në event ndanë përvojën e tyre edhe folës të mirënjohur nga publiku shqiptar dhe më gjerë si: Mirela Sula, Sheki Useini,

Ahmet Shala, Ermal Mamaqi dhe Alketa Vejsiu. Vasili dhe të ftuarit përcollën dije, vlerë, dashuri, forcë dhe besim.

Suksesi vjen natyrshëm, nëse përmirësojmë mënyrën e të menduarit, besimet tona e rrjedhimisht veprimet dhe sjelljen. Suksesi kërkon qartësi, dëshirë dhe aftësi, e të gjitha këto mund të mësohen. Njeriu zgjedh të jetë i sukseshëm, nuk lind. Ata që janë të etur, të qartë dhe të përgatitur për sukses, janë të pandalshëm në rrugëtimin e tyre. Nëse secili prej nesh përditë bëhet pak më i mirë sesa ishte një ditë më parë, natyrshëm jeta dhe çdo gjë tjetër do të përmirësohet.

Përbushja individuale është një proces që nuk ka fund. Burimi i saj është investimi tek zhvillimi personal dhe përkrahja e mendësisë së duhur. Mendësia e duhur u jep trajtën qëndrimeve tona, duke përcaktuar nivelin e arritjeve dhe të suksesit në jetë.

Eksplorimi i formulës së suksesit, mesazhet motivuese, bindjet progresive, ndërveprimi dhe energjia e lartë, e bënë “Rruga Drejt Suksesit 2021”, një eksperiencë unike në rrugën e rritjes dhe zhvillimit. Duke përfituar nga transmetimi virtual në mjediset e ngrohta familjare, në ekranet e televizorëve apo kompjuterike, të gjithë pjesëtarët e familjeve, fëmijë e të rritur patën mundësi të përfshiheshin me mënyrën e tyre.

“Rruga Drejt Suksesit”, event-trajnimi më i madh në rajon që kontribuon në rritjen dhe zhvillimin personal, ka edhe një dimension tjetër shumë të rëndësishëm human - të gjitha të ardhurat shkojnë për bamirësi.

Ndaj buzëqeshjen me Lay's

#LaysSmiles

Këtë vit Lay's ka përcjellë në të gjithë botën mesazhin kuptimplotë "Ndaj Buzëqeshje me Lay's".

Lay's kontribuon për një jetë më cilësore për të rinjtë duke suportuar talentet e reja. Në këtë kuadër, në Shqipëri, në bashkëpunim me Rektoratën e Universitetit të Tiranës, u përzgjedhën 20 studentë ekselentë ku secilit prej tyre iu dhurua një çek me vlerën 100'000 lekë.

Disa prej studentëve u bënë pjesë e xhirimeve të fushatës së komunikimit në median televizive edhe në atë dixhitale. Më 18 tetor u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së çeqeve tek studentët. Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishin Rektori

i Universitetit të Tiranës z.Artan Hoxha, si edhe Presidenti i Aqna Group z.Vasil Naçi.

Studentët kanë përcjellë falënderimet e tyre dhe kanë shprehur mirënjohje jo vetëm për përfitimin monetar, por edhe për eksperiencën që përjetuan.

Një buzëqeshje mund të shkojë shumë më larg nga sa mund ta imagjinoni. Së bashku ne mund ta bëjmë botën të buzëqeshë. Ndaj buzëqeshjen me Lay's!





Siguria dhe shëndeti në punë - prioritet në Agna Group

“**S**iguria e para” është besimi që udhëheq punën në Agna Group dhe është pjesë integrale e çdo procesi e procedure pune në organizatë. Përtej të qenit detyrim ligjor, “Siguria e para” lidhet ngushtë me përkushtimin për të garantuar kushte sa më të mira dhe të sigurt për punonjësit, të cilët janë “klientët e parë” të kompanisë.

Për këtë arsye të gjitha aspektet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë udhëheqin standardet, procedurat dhe praktikën e punës. Kjo lidhet ngushtë edhe me kujdesin për partnerët, furnitorët, vizitorët në mjediset e punës, apo deri tek publiku i gjerë në kontaktet dhe ndërveprimet me kompaninë.

Në Agna Group të gjitha hapat që ndërmerren për ngritjen e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë janë të qëndrueshme dhe të strukturuar në harkun vjetor.

Që para se të marrë detyrën e re, gjatë programit të orientimit të punonjësve të rinj (POPR) çdo

individ që punësohet në Agna Group kryen seancat e nevojshme të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Trajnimet për sigurinë dhe shëndetin në punë zhvillohen periodikisht për të gjithë punonjësit e organizatës.

Në vijim të proceseve dhe standardeve të vendosura ndër vite, gjatë vitit 2021 u mbajtën mbledhjet periodike të këshillave të sigurisë dhe shëndetit në punë, u vijua me rinovimin dhe plotësimin e sinjalistikës vertikale e asaj horizontale në mjediset e kompanisë, me përditësimin dhe certifikimin e të gjitha mjeteve dhe sistemeve të punës. U rinovuan sipas parametrave periodik pajisjet e mbrojtjes individuale, si dhe vijuan trajnimet e punonjësve me synim rritjen e vazhdueshme të zotësive përmes thëllimit të njohurive në këtë fushë.

Trajnime specifike sipas sektorëve dhe profileve të punës u zhvilluan gjithashtu, në grupe të vogla, pranë vendeve të punës. Ndërkohë seanca të tjera u kryen në distancë (online), përmes platformës ZOOM në lidhje të drejtpërdrejtë nga salla virtuale e trajnimeve të Agna Leadership Academy.

SHIJO DHE FITO ME PEPSI


Pepsi, sponsor zyrtar i platformës më të suksesshme futbollistike UEFA Champions League, ka sjellë në Shqipëri aktivizime dhe surpriza për konsumatorët-sportdashës. Përmes promovimit "Fito me Pepsi", Pepsi ka shpërblyer konsumatorët sportdashës me dhurata speciale si: scooter elektrik, çanta shpine të UEFA Champions League dhe topa futblli.

Në çdo sezon të UEFA Champions League, Pepsi ofron dhurata dhe argëtim për konsumatorët e tij sportdashës dhe jo vetëm. Është ndjesi e bukur të jesh pranë konsumatorëve tifozë, ndërsa ata përjetojnë emocionet e sportit më popullor në Shqipëri dhe shijojnë Pepsi.

Gjatë muajve të verës Pepsi i ftoi konsumatorët e tij që të shijonin Pepsi dhe të fitonin dhurata në dyqanet Adidas dhe Intersport. Ky promovim veror synoi të shtonte sado pak gëzim dhe lojë ndërsa jeta ju kthehej disi ritmit normal pas një viti të vështirë pandemie.

Pjesëmarrësit mund të fitonin dhurata duke blerë Pepsi, IVI, 7UP dhe duke regjistruar kodin e kartës gërvishtëse tek adresa www.shijopepsi.com. Fituesit u shpallën çdo të martë në faqen zyrtare të @PepsiAlbania në Instagram.

#ForTheLoveOfIt




Heineken UEFA Champions League



Përgjatë sezonit të Uefa Champions League 2020-2021 sportdashësit i ndoqën ndjeshjet nga shtëpia, por përsëri nuk ishin vetëm, sepse komuniteti i fansave të UCL është mbi 70milion.

Heineken si çdo vit organizoi promovimin e sezonit të UCL, gjatë të cilit 26 konsumatorë patën mundësi të fitonin kuponin special për të zgjedhur vetë dhuratën e preferuar në dyqanet Adidas.

Heineken, sponsor zyrtar i platformës më premium futbollistike UEFA Champions League, ka sjellë ndër vitë në Shqipëri aktivizime dhe surpriza për konsumatorët dhe sportdashësit përgjatë sezonit të UEFA Champions League. Kjo është tashmë një traditë unike nga Heineken.



“FESTA E MIQËSISË”

Tradita më miqësore e vitit



“Festa e Miqësisë”, për të gjashtin vit vijoi rrugëtimin në 10 qytete të Shqipërisë, duke ofruar 37 netë plot argëtim, muzikë, lojra, birra Elbar dhe miq të vërtetë. “Festa e Miqësisë” u mirëprit më shumë se kurrë më parë, pas një viti pushimi për shkak të pandemisë.

Tingujt e muzikës nga miqtë special të kësaj feste, Redon Makashi, Aleksander Gjoka, Elton Deda, Mateus Frroku, Era Rusi, Orgesa Zaimi, Land Kademi, Simpatiko Band, Devis Xherahu, etj, shoqëruan mbrëmjet e sezonit veror 2021.

Këtë vit, në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve, një pjesë e të ardhurave nga organizimi i “Festës së Miqësisë” u investuan në mbjelljen e fidanëve të rinj dhe bimëve dekorative në secilin qytet.

Gjatë sezonit të vjeshtës organizatorët u kujdesën që këndet e gjelbërta të realizoheshin duke i shtuar qendrës së qyteteve hapësira të reja për të gjithë.

Tradita e bukur e “Festës së Miqësisë” do të vijojë edhe gjatë vitit 2022 në qytete të tjera për t’i dhënë mundësinë miqve tanë të shijojnë birrën Elbar dhe të kalojnë mbrëmje të paharrueshme.

Ndërkohë, gjatë muajit dhjetor, ju presim bashkë me miqtë në “Këndin e Miqësisë” në qendër të Tiranës, të shijojmë atmosferën e bukur të muajit të festave me shoqëri të mirë dhe me birrën Elbar.

Festa e Miqësisë, festë për miq të vërtetë!



f i birraelbar

BIRRË GRURI E TURBULLT
KOMBINIM I PËRSOSUR ME USHQIMIN

BIRRA
ELBAR
Weiss



NO TIME TO DIE

EVENT EKSKLUZIV ME HEINEKEN

Heineken, në një event special, mirëpriti për herë të parë në Shqipëri vazhdimin e sagës James Bond me filmin "No Time to Die".

Në kinema "Cineplexx" TEG, u organizua një mbrëmje gala me të ftuar special nga bota e medias, artit dhe kulturës.

Heineken, bashkë me James Bond sollën këtë vit një eksperiencë unike për të gjithë fansat e tyre duke bashkuar në një fushatë të vetme marketingu të integruar magjinë e botës së aventurës dhe misterit të agjentit 007 dhe surprizat e një brandi global dhe unik siç është Heineken.

Kjo mbrëmje ekskluzive u dha mundësinë të gjithë të ftuarve të shijonin të parët magjinë e "No Time to Die".

Heineken, ka qenë pjesë edhe në seritë e tjera të agjentit 007 si: "The World is Not Enough", "Die Another Day", "Casino Royale", "Quantum of Solace", "Skyfall" & "Spectre".



CITY ART



KINO



TRIBECA



NOOR



WHISKEY

AFTERWORK
BY Heineken®

"PAS-PUNE" ME HEINEKEN

Nëse ke mbaruar punën dhe mezi pret të relaksohesh në shoqërinë e kolegëve me një birrë të zgjedhur, "Pas-pune me Heineken" është mundësia jote. Për të kultivuar sado pak këtë mënyrë çlodhjeje në prag të fundit të javës së punës, Heineken organizoi për 5 javë programin "Pas-pune" me Heineken.

Kolegë e miq u bashkuan me "shared location" për të shijuar me njëri-tjetrin birrën e çlodhjes pas pune, nën ritmet e një muzike fantastike, në një atmosferë relaksi dhe gëzimi. Heineken synon që ta kthejë këtë program në një traditë në baret dhe lokalet më "IN" në Shqipëri.



Produkte të reja

NESTLÉ DESSERT

Çokollatat Nestlé Dessert janë krijuar nga varietete të zgjedhura të kakaos, por edhe nga përbërësit më të pastër, si ekstrakti natyral i vaniljes dhe 100% gjalpë kakaos, për t'ju ofruar cilësinë më të mirë. Kanë shije perfekte, aromë të pasur dhe teksturë prej kadifeje.

Gama e çokollatave Nestlé Dessert ju ofron mundësi të panumërta për t'u frymëzuar dhe për të krijuar ëmbëlsirat më të shijshme. Ofrohet në 2 shije të reja: Karamel dhe Praline.



NESCAFÉ BLACK ROAST JAR

Kur dëshironi një kafe më të errët, më të fortë dhe më të pasur, keni nevojë për një kafe të çastit NESCAFÉ Black Roast.

Plot karakter dhe me shije të pasur kafeje, për një fillim plot energji të mëngjesit. Kokrrat e zgjedhura të kafes piqen me kujdes për të krijuar një kafe të pasur si në shije ashtu edhe në aromë.



FILLS

Produkt me cilësi të lartë dhe me një çmim të përshtatshëm. Krokante e mbushur me çokollatë të butë dhe krem lajthie.

SOFT STRUDEL

Strudel i butë Vienna, bazuar në recetën tradicionale, është një produkt me cilësi të lartë, me përbërës të zgjedhur me kujdes, në një ekuilibër perfekt të shijes së butë dhe të ëmbël. Ofrohet në 2 shije: Luleshtrydhe dhe Pjeshkë.

ROLL

Një balancim perfekt i cilësisë së lëndës së parë dhe shijes finale të Vienna Rolls. Produkt i përshtatshëm për konsum të shpejtë dhe për servirje në shtëpi. Shoqëruet i mirë i kafes tuaj. Ofrohet në paketimin 150g me 3 shije: Kakao, Lajthi dhe Luleshtrydhe.



LETËR KUZHINE PERFEX

Letër Kuzhine Perfex 100% celulozë. Për përdorim të përgjithshëm, e përshtatshme për çdo sipërfaqe. Në formatet me 2 dhe 3 shtresa.



LETËR HIGJENIKE PERFEX

Letra higjienike Perfex 100% celulozë. Të buta, me 3 shtresa, me aroma dhe formate të ndryshme.

SAPUN AROMATICS

Sapunët Aromatics vijnë në dy formate: Në paketim 125gr me kuti kartoni dhe në paketim 90gr me letër. Sapunët janë me aroma të ndryshme dhe e lënë lëkurën të butë pas çdo përdorimi.

SHAMPO TRUPI AROMATICS

Shampo trupi Aromatics me prebiotik, vitamin E dhe Aloe vera. Janë produkte vegane. Vijnë në paketim 650ml dhe në aroma të ndryshme.

SAPUN NATURA

Përmban sapun të ngurtë dhe të lëngshëm. Përmbajtja e tyre antibakteriale jep siguri për duart, por edhe butësi. Vjen për konsumatorët në 3 aroma të këndshme.



DUEL DETERGJENT I LËNGSHËM

Vjen në formatin 2.6L, në 3 variante, për rroba të zeza, me ngjyrë dhe universal. I jep rrobave një aromë fantastike.

DETERGJENT ENËSH DUEL

Eliminon yndyrnat nëpërmjet efektit të sodës që përmban. Vjen në paketime 450ml, 900ml dhe me 4 aroma.

ZBUTËS DUEL

Zbutësi i ri i rrobave Duel në formatin 2.6L. Në 2 aroma: Blue Angel dhe Soft Cotton. I jep rrobave tuaja plot aromë e butësi. Lehtëson hekurosjen.

DUEL PREMIUM

Zbutësit Duel janë të koncentruar, lehtësojnë hekurosjen dhe neutralizojnë elektricitetin statik. Me përdorimin e tyre rrobat bëhen të buta dhe plot aromë. Vjen në formatet 1L dhe 1.9L.



IRI
MË PROVO 😊



MAHNITE BOTËN ME IVI

"Mahnite botën!" është mesazhi që IVI përcjell duke na ftuar të jetojmë plot kreativitet, të shkojmë përtej asaj që duket, të eksplorojmë një hap më tej drejt ndjesive. Të bëjmë çdo gjë plot gjallëri, gëzim dhe kënaqësi, duke zbuluar dimensione të reja të vetes, duke i ofruar vetes dhe botës më të mirën tonë.

Këtë verë, IVI erdhi me dy surpriza, dy kombinime frutash me shije që nuk i kishim provuar kurrë më parë, IVI MJEDËR - LIMON & IVI FRUTA PYLLI - SHALQI.

Make the world go WOW... #MahniteBotën!

**NDIZ
DRITAT
E FESTAVE!**





TË DHUROJMË FESTËN ME AMSTEL!

Amstel këtë verë dhuroi edhe më shumë gëzim për konsumatorët e tij, në festat e tyre. 100 konsumatorë me fat përjetuan surprizën e festës nga Amstel: Birrën e preferuar, zbukurimet e festës dhe tortën speciale, pra gjithçka që duhej për një festë të bukur në shtëpi.

Prej vitesh Amstel është pjesë e gëzimeve tona, si një mik i mirë që na rri pranë ndërsa gëzojmë e buzëqeshim kur festojmë ditëlindjet, gëzimet e familjes, e momentet e arritjeve tona.

Amstel, sepse kështu na pëlqen!



Spring
burimi i vrizit

ju uron
**Gëzuar
Festat**



**Festat
fillojnë
me një
Heineken
të ftohtë**



Agna Group wishes you a

Happy Holiday

season and a prosperous

New Year!



BASHKË në aktivitete SOCIALE, KULTURORE, SPORTIVE



Maratona e Vrapit në Voskopojë.



Kampionati i 28-të Kombëtar për Fëmijë, Kadetë, Junior, U21 dhe Senior në karate.



"Shqipëria Punon Tokën - Shijo Produktet Lokale" organizuar nga Bashkia Tiranë dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.



Festivali Mbarëkombëtar i komedisë "KoKo Fest".



Stafi i Agna Group në ndihmë të fëmijëve telasemikë.




Glina mbështet Miss Summer World 2021.



Edicioni i pestë i Maratonës së Tiranës.



Landi Pasku, Kampion i Shqipërisë në Kampionatin Kombëtar Individual.



Maratona "Këngë Moj".



Maratona e Vrapit në Dropull.



Festa e Birrës në Korçë.



Nona Fest në Përmet.



Koncerti i Aurela Gaçe-s.



"Tiranathlon", edicioni i parë në sprint, pedalim dhe not.



**GËZUAR
FESTAT!**



GLINA®

Nga i famshmi dhe i vetmi burim i Glinës

**Gëzuar
për shumë vjet!**



PULË ME PATATE

përgatitja: Ngrohni furrën në 200°C. Vendosni në tavë pulën dhe patatet përreth. Në një tas, përzieri hudhrën, koncentratin e pulës Maggi, lëng limoni dhe piper. Me përzierjen lyeni pulën nga të gjitha anët. • Piqeni për 1 orë e 40 minuta në 180°C, në pozicionin e mesëm të furrës. Pula e shijshme është gati për t'u servirur!

përbërësit:

1 pulë e mesme,
1/2 kile patate
1 thelpi hudhër (e grirë)
Trumzë e freskët
1 limon (lëkura dhe lëngu)
1 koncentrat Maggi pule
50ml vaj ulliri, kripë dhe piper



Maggi

LUMTURIA NË
KUZHINËN TUAJ!

RECETA ME MAGGI



PAPARDELE ME MISH VIÇI DHE TRUMZË TË FRESKËT

përgatitja: Pastroni mishin nga dhjamrat. Vendosni një tigan në nxehtësi të lartë me 2 lugë gjelle vaj ulliri dhe trazoni mishin e viçit deri sa të marrë ngjyrë kafe. • Hiqeni mishin e viçit nga tigani, ulni nxehtësinë dhe hidhni verën. Shtoni 1/2 filxhan ujë dhe koncentratin e viçit Maggi. • Zieni makaronat, kullojini dhe transferojini në tigan. Prisni fileton e viçit në feta dhe vendosini në tigan. Shtoni trumzën, lëkurën e limonit, djathin Grana, 3 lugë gjelle vaj ulliri dhe piper. Përziejini deri sa përbërësit të lidhen dhe papardelet me mish viçi janë gati për t'u servirur.

përbërësit:

300g Papardele Barilla
200g fileto viçi
1/2 gotë verë të bardhë
1/2 lëkurë limoni
1 lugë gjelle trumzë e freskët
Kripë dhe piper
1 koncentrat Maggi viçi
5 lugë gjelle vaj ulliri
3 lugë gjelle djathë Grana i grirë

METAVVERSE

jeta virtuale = jeta fizike

SI FILLOI METAVVERSE!

Në fund të qershorit CEO i Facebook Mark Zuckerberg iu tregoi punonjësve të tij një iniciativë të re ambicioze. E ardhmja e kompanisë do të shkonte shumë përtej projektit të saj aktual për ndërtimin e një grupi aplikacionesh sociale të lidhura dhe disa pajisje për t'i mbështetur ato. Në vend të kësaj, tha ai, Facebook do të përpiqet të ndërtojë një grup përvajsh maksimaliste, të ndërlidhura drejtpërdrejt në një botë të njohur si Metaverse.

Divizionet e kompanisë me fokus produkte për komunitetet, krijuesit, tregtinë dhe realitetin virtual do të punojnë gjithnjë e më shumë për të realizuar këtë vizion. "Ajo që unë mendoj se është më interesante është se si këto tema do të bashkohen në një ide më të madhe," tha Zuckerberg. "Qëllimi ynë kryesor në të gjitha këto iniciativa është të ndihmojmë në sjelljen e Metaverse në jetë."

ÇFARË ËSHTË METAVVERSE?

Mendojeni sikur interneti të vijë në jetë, ose të paktën i paraqitur në 3D. Zuckerberg e ka përshkruar atë si një "mjedis virtual" ku mund të hysh dhe të ndërveprosh, në vend që ta shikosh vetëm në një ekran. Në thelb, është një botë e komuniteteve virtuale të pafundme, të ndërlidhura, ku njerëzit mund të takohen, të punojnë dhe të luajnë, duke përdorur kufje dhe syze të realitetit virtual, aplikacione për smartphone ose pajisje të tjera. Gjithashtu do të përfshijë aspekte të tjera të jetës në internet si blerjet dhe mediat sociale.

ÇFARË MUND TË BËNI NË METAVVERSE?

Mund të shkoni në një koncert virtual, të bëni një udhëtim online si dhe të blini dhe të provoni veshje dixhitale. Metaverse mund të jetë gjithashtu hapi i duhur për kalimin e punës nga shtëpia në këtë periudhë pandemie. Në vend që bashkëpunëtorët të shihen në një konferencë online në ekran, ata mund të takohen virtualisht. Facebook ka lançuar programin e takimeve për kompanitë, të quajtur Horizon Workrooms, për t'u përdorur me syzet e tij Oculus VR. Aktualisht ato kanë një kosto të lartë, duke e bërë të vështirë zgjerimin në masë. Projekti teknik do të jetë i hapur, duke mundësuar shumë kompani të ndryshme teknologjike të ofrojnë alternativën e tyre, por gjithmonë brenda Metaversit, duke respektuar një set standardesh të parashtruara për të evituar që të krijohen grupe të Metaversit të Facebook-ut dhe të Metaversit të Microsoft-it.

ËSHTË KY NJË PROJEKT ESKLUZIV I FACEBOOK?

Zuckerberg ka pranuar që ky nuk është një projekt që i përket një kompanie të vetme. Në bisedime për t'u bashkuar me Metaverse janë dhe Microsoft dhe Nvidia. Gjithashtu një rol shumë të rëndësishëm në këtë projekt po marrin edhe kompanitë e lojërave elektronike. Epic Games, kompania e lojës super të suksesshme "Fortnite", ka grumbulluar më shumë se 1 Miliardë dollarë nga investitorë të ndryshëm për të bashkëpunuar në zgjerimin e Metaverse. Platforma rivale, Roblox, e ka bërë tashmë të qartë vizionin e saj duke e konsideruar Metaversin si e ardhmja, si një vend ku "njerëzit

bashkohen së bashku për eksperiencë të jashtëzakonshme në 3D, ku mësojnë, punojnë, luajnë dhe krijojnë shoqëri të reja". Markat e ndryshme konsumatore janë duke ju bashkuar trendit. Marka e modës Gucci ka filluar një bashkëpunim me Roblox për të shitur një koleksion aksesorësh dixhitale. Marka e produkteve estetike Clinique ka filluar të shesë monedha dixhitale si një hap i parë i përshtatjes me botën e Metaverse.

A DO TË JETË METAVVERSE NJË TJETËR MËNYRË PËR TË MARRË MË SHUMË TË DHËNA PERSONALE?

Përfaqimi i Metaverse nga Zuckerberg, në disa mënyra bie ndesh me një parim qëndror të entuziastëve më të mëdhenj të botës virtuale. Ata e përfytyrojnë Metaverse si glirimin e kulturës online nga platformat e teknologjisë si Facebook, të cilat morën pronësinë e llogarive, fotove, postimeve dhe blerjeve të njerëzve dhe i shitën këto informacione të gjitha kompanitë e interesuara.

"Ne duam të jemi në gjendje të lëvizim nëpër internet me lehtësi, por duam gjithashtu të jemi në gjendje të lëvizim nëpër internet në një mënyrë që nuk gjurmohemi dhe nuk monitorohemi," thotë Steve Jang, një partner menaxhues në Kindred Ventures, kompani e fokusuar në teknologjinë e kriptomonedhës.

Nga prezantimi i Zuckerberg, duket qartë që Facebook dëshiron të vazhdojë me të njëjtin model biznesi, i cili bazohet në përdorimin e të dhënave personale për të shitur reklama të targetuara, por tashmë në Metaverse. "Reklamat do të vazhdojnë të jenë një pjesë e rëndësishme e strategjisë të asaj që ne bëjmë dhe ndoshta do të jetë gjithashtu një

pjesë domethënëse e Metaverse", ka deklaruar Zuckerberg, ndërkohë që komuniteti është i shqetësuar për përpjekjet e Facebook për të udhëhequr rrugën drejt një bote virtuale që mund të kërkojë edhe më shumë të dhëna personale dhe të ofrojë potencial më të madh për abuzim dhe dezinformim kur ende nuk janë rregulluar ato probleme në platformat aktuale.

POLEMIKAT!

Shumë personalitete të botës dixhitale janë skeptikë përse i përket Metaversit. Spekticismi i tyre bazohet në momentin e lançimit, që përkon me realitetin e situatës së pandemisë. Gjatë periudhës së pandemisë, Facebook ka përjetuar një situatë të vërtetë bipolare, ku nga njëra anë ka qënë burim informacioni mbi Covid-19 dhe masat e ndërmarra nga organizatat botërore dhe lokale, por nga ana tjetër ka qënë dhe burimi kryesor i keqinformimit, i teorive konspirative dhe lajmeve të rreme, që kanë krijuar panik të kotë duke shpërndarë informacione të gabuara, të pavërteta apo me burime jo të besueshme. Pikërisht në mes të kësaj stuhie, ku bota priste një reformim të platformës më të madhe të medias sociale, vjen shpallja e Metaverse. Në vend që të sqarojë dilemat dhe polemikat aktuale, ajo hap shtigje të reja me plot pikëpyetje. Suksesi i Metaverse mbetet për t'u parë dhe momentalisht sytë janë përsëri te Facebook dhe e ardhmja e tij!


Burimet: The Verge, Facebook, Times.com, sifted.eu



Albartex

o u t d o o r a d v e r t i s i n g

THE FIRST AND THE BIGGEST OOH ADVERTISING COMPANY
IN ALBANIA OPERATING SINCE 1992.




Mega Billboard



Billboard



Piza




City Light



Facade



Bus Station



Digital



LED Screen

Tel. 04 2239 036 - E: info@albartex.net - www.albartex.net



★ ON TIME CONCEPT ★
ADVERTISING AGENCY

EVENTS
BRAND
IMAGE
LOGO
CAMPAIGN
PRINT
OUTDOOR
CARS
ONLINE
EVENTS
PROMOTION
DIRECT MAIL
BRAND
IMAGE
CAMPAIGN
OUTDOOR
ONLINE





“From my life experience I have learned that if someone has a great desire to achieve something, strong reasons, self-confidence, discipline and dedication with all his/her being, he/she will achieve it, eventually. It all starts from within...” – Vasil Naçi

The ROAD to SUCCESS

by VASIL NAÇI

MASTER YOUR BUSINESS

by VASIL NAÇI

direct connection through ZOOM platform. During the four days, May 20-23, Vasil Naçi and a team of invited experts: Prof. Sherif Bundo, Dr. Julia Goga-Cooke, Dr. Alma Bici, Dritan Mezini and Arti Marko, shared the best of their knowledge and experience, as well as the most contemporary practices in finance, marketing, digital transformation, innovation, sales, etc.

Although remotely, “Master your Business” enabled participants to exchange ideas and experiences, valuable time reflecting on their businesses, vision and priorities in its management, as well as together with the combination of the advanced knowledge accompanied with high levels of energy.

The ongoing extension of economy of the Albanian economic environment, coping with overload of information and rapid change, demands from businesses clarity and efficient decision-making. Investors or entrepreneurs aiming for success are aware that the path of growth and development is the safest. And to accelerate the pace of success by saving time and energy, they take care to experience and follow the best view or practices.

“Master your Business”, nowadays a part of the training event that Vasil Naçi develops as part of social responsibility and desire to contribute to the community, came at a critical time of the pandemic to convey the message that times of great challenges are also times of great opportunities, are times for change, improvement and exponential growth. Each challenge overcome with success means more market share, more profits, more growth.

Beyond the challenges of the time that we are living, this year brought an excellent gift for the business community, the training event “Master your Business”, a program entirely dedicated to business, organized for the first time in Albania. A fantastic opportunity for anyone who wants to grow and take his venture one step further.

Created by the demand of entrepreneurs and individuals in love with business, so they can benefit from the most successful knowledge, models, and practices in a local and global level, “Master your Business” was built with the aim of providing knowledge, tools, practices, and strategies for sustainable and long-term growth.

Due to the circumstances of the pandemic restricting us, this first edition of “Master your Business” took place online, in

The tradition continues stronger and more beautiful. Launched in 2016, the training event named “The Road to Success” was held for the sixth time this year. A perfect set-up from “Aga Leadership Academy” and “On Time Concept”. Six years of growth, success, and thousands of participants enthusiastic and committed to continuous development and improvement.

For the second year in a row, in a long weekend that started at noon on November 19th and ended three days later, “The Road to Success” took place live (online) for more than 25 hours, on ZOOM platform. About 2,000 participants, who believe in personal growth and development as the best way to guarantee success, attended the event live and hundreds more in groups with staff, friends or family.

The virtual format made it possible this year also “The Road to Success” to be streamed in over 15 different countries such as: (USA, Italy, Switzerland, United Kingdom, Kosovo, Northern Macedonia, Serbia, Greece, Germany, etc.).

The main organizer and speaker Vasil Naçi, entrepreneur, founder, President and CEO of Agra Group, with over 30 years of experience in business, author of books on business and personal development, trained by the best in the field of business, shared with participants the most up to date knowledge for personal and professional growth and development. In the event, well-known speakers from the Albanian public and broader such as: Mirela Sula, Sheki Useini, Ahmet Shala, Ermal Mamaqi and Alketa Vejsiu, shared

their experience. Vasili and this group of guests conveyed knowledge, value, love, strength and faith.

Success comes naturally if we improve our way of thinking, our beliefs and consequently our actions and behavior. Success requires clarity, desire and skill, and all of these can be learned. One chooses to be successful; one is not born. Those who are eager, clear and prepared for success are unstoppable in their journey. If each of us daily becomes a little bit better than we were the day before, naturally life and everything else will improve.

Personal fulfillment is a never-ending process. Its source is investing in personal development and supporting the right mindset. The right mindset shapes our attitudes, determining the level of achievement and success in life.

Exploring the formula of success, motivational messages, progressive beliefs, interaction and high energy, made “The Road to Success 2021”, a unique experience on the path of growth and development. Benefiting from virtual broadcasting in warm family environments, on TV or computer screens, all family members, young and old, had the opportunity to participate in their own way.

“The Road to Success”, the largest training event in the region that contributes to personal growth and development, has another especially important human dimension- all proceeds go to charity.



www.agnagroup.com

